



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 686, datë 2.9. 2020**

**PËR**  
**KRITERET E DHËNIES SË BURSAVE PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË**  
**SHQIPTARE, PËR TË STUDIUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, NGA**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ë”, të nenit 5, të Ligjit nr. 16/2018 “Për diasporën”, të ndryshuar, të nenit 11, të Ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, si dhe në vijim të nenit 7, të vendimit nr. 504, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e 9 (nëntë) bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2020-2021.
2. Bursa e studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare përfshin mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Për vitin akademik 2020-2021 do të akordohen 9 (nëntë) bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë për vendet si më poshtë vijon:
  - a. 3 (tre) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;
  - b. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit Arbëresh në Itali;
  - c. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;
  - d. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgaria;



4. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara në vendet e përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, bëjnë propozimet për kandidatët për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2020-2021. Ato janë përgjegjëse për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar për kandidatët përfitues të bursës.
5. Dokumentacioni që do të paraqitet nga aplikantët duhet të jetë i legalizuar në përputhje me legjislacionin që rregullon njohjen dhe përdorimin e dokumenteve zyrtare të lëshuara jashtë vendit.
6. Kriteret bazë për përfitimin e bursës që duhet të plotësoj aplikanti janë si më poshtë vijon:
  1. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlefshme me të;
  2. Të mos jetë i diplomuar në ciklin e plotë të studimeve universitare;
  3. Të jetë student nga komunitetet shqiptare të diasporës dhe që jeton në një nga vendet e lartpërmendura në pikën 3 të këtij vendimi.
7. Kriteret për përfitimin e bursave, sipas programeve ku do të studiojnë shtetasi e huaj me origjinë shqiptare, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Për ndjekjen e procesit dhe vlerësimin përfundimtar të dokumenteve të kandidatëve të cilët do të përfitojnë bursë studimi, institucionin e arsimit të lartë dhe programin e studimit ku do të studiojnë krijohet Komisioni i Bursave për Diasporën, me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët do të propozohen nga ministria përgjegjëse për arsimin (1 anëtar), ministria përgjegjëse për politikën e jashtme (1 anëtar) dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës (1 anëtar).
8. Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kryejë pagesat e mësuesve të nevojshëm për mësimin e gjuhës shqipe në vitin e parë të studimeve për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2020-2021.
9. Financimi i bursave në zbatim të këtij vendimi, për vitin akademik 2020-2021 ka një vlerë prej 71 520 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) eurosh. Ky financim do të përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.
10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**

**ANEKSI 1****MASA E BURSËS PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE**

<b>1.</b>	<b>Studentët me origjinë shqiptare</b>	
	Tarifa e studimit	40000 lekë/vit = 30 Euro/muaj
	Akomodimi	300 Euro/muaj
	Shpenzimet ushqimore	270 Euro/muaj
	<b>Totali mujor i bursës</b>	<b>600 Euro /muaj</b>
	<b>Totali vjetor i bursës (9 studentë)</b>	<b>64800 Euro</b>

<b>2.</b>	<b>Asistentët për mësimin e gjuhës shqipe</b>	
	Paga Mujore	560 Euro/muaj
	Paga vjetore (1 asistent)	<b>6720 Euro</b>
	<b>Vlera vjetore totale për studentët dhe asistentët</b>	<b>71520 Euro</b>